

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6130
E shtunë, 3 tetor 2020
çmimi 0.40 €

Veseli thotë se
papërgjegjësia e qeverisë
po rrezikon falimentin e
qindra bizneseve I FAQE 9



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ME MOTON "BASHKË PA KUFË. NË NJË RAJON PA KUFËJ", QEVERIA E KOSOVËS DHE AJO E SHQIPËRISË KANË ZHVILLUAR TË PREMTE NË TIRANË MBLEDHJEN E GJASHTË TË PËRBASHKËT

Kosova dhe Shqipëria synojnë heqjen e kufirit mes dy shteteve



Republika e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë kanë nënshkruar të premten katër marrëveshje, tri protokolle, pesë memorandume dhe kalendarin e përbashkët kulturor vjetor.

Në mbledhjen e gjashtë të përbashkët të dy qeverive, kryeministrat e të dy vendeve kanë vlerësuar se me këto marrëveshje Kosova dhe Shqipëria po hyjnë në një fazë të re të bashkëpunimit

tonë ndërshtetëror. Avdullah Hoti dhe Edi Rama kanë deklaruar se synim i përbashkët i Kosovës dhe i Shqipërisë është heqja e kufirit në funksion të zbatimit të katër lirive të BE-së I FAQE 4-5

THAÇI BISEDON ME LAJÇAKUN: KOSOVA ËSHTË E PËRKUSHTUAR PËR DIALOG QË ÇON NË NJOHJE RECIPROKE

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka zhvilluar një bisedë virtuale me të dërguarin e posaçëm të Bashkimit Evropian (BE) për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. Presidenti Thaçi ka theksuar se

Kosova është e përkushtuar për procesin e dialogut që çon në njohje reciproke, si mënyra e vetme për ta siguruar paqen afatgjatë në rajon dhe që do ta përshpejtonte procesin e integritetit në BE I FAQE 3



ASNJË PERSON I VDEKUR NGA COVID NË 24 ORËT E FUNDIT

I FAQE 7



AKTUALE



DONALD TRUMP DHE MELAINA TRUMP REZULTOJNË POZITIVË ME COVID-19 F. 2

MINISTRI QUNI VIZITOI KOMPANITË LIDERE TË INDUSTRIËS SË MBROJTJES SË TURQISË F. 7

ZVICRA ARRESTON TRE SHTETAS TË KOSOVËS, KISHIN "LIDHJE ME IS-IN DHE AL-KAIDËN" F. 2

EKONOMI

QEVERIA DUHET T'I TRAJTOJË ME KUJDES HUMBJET E INDUSTRIËS SË RËNDË NGA PANDEMIA F. 9

NË PRITJE TË KRIJIMIT TË VENDEVE TË REJA TË PUNËS F. 9



SPORT

MINISTRIA E KULTURËS JEP ÇMIMET PËR TEATËR F. 13



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepgishtë - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...


Trumpi i bën thirrje Shqipërisë të largohet nga iniciativa kineze 17+1

UASHINGTON, 2 TETOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, i ka bërë thirrje Shqipërisë ta lërë formatin 17+1 të Kinës, ndërsa ka thënë se është i kënaqur nga roli i fortë i Shqipërisë në Nismën e Tre Deteve. Kërkesa e Trumpit ndaj Shqipërisë është bërë në një letër të cilën ia ka dërguar kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama.

Letra u publikua nga ana e kryeministrit Rama, në profilin e vet në rrjetin social "Facebook". Formatin kinez 17+1 është nisma e qeverisë kineze për t'i promovuar marrëdhëniet e biznesit dhe të investimeve midis Kinës dhe vendeve të ish-blokut komunist të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Në këtë nismë bëjnë pjesë edhe Serbia, Bosnje dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kroacia, Sllovenia, Bullgaria, Republika e Çekisë, Estonia, Greqia, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Rumania dhe Sllovakia.

Ndërsa Nisma e Tre Deteve është një platformë politike që ka për qëllim t'i nxisë lidhjet mes vendeve në Evropën Qendrore dhe Lindore, duke



mbështetur projektet e Shteteve të Bashkuara të infrastrukturës, energjisë dhe Amerikës unë dua t'ju ato digjitale. "Në emër të falënderoj juve për lidhshimin e

Shqipërisë në rajonin e Ballkanit dhe nëpër Evropë, për ekspozimin e ndikimit malinj të Kinës, abuzimet me të drejtat e njeriut dhe praktikën grabitqare të huazimit. Mbështetja juaj e hapur për rrjetet e sigurta të telekomunikacionit po jep një shembull të fortë dhe shpresoj që Shtetet e Bashkuara dhe Shqipëria të mund të nënshkruajnë së shpejti një Memorandum Mirëkuptimi mbi sigurinë 5G, i cili hap rrugën që edhe vendet e tjera në Ballkan ta bëjnë të njëjtën gjë", thuhet në letrën e Trumpit. Shqipëria është i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor që i është bashkuar iniciativës së administratës amerikane "Rrjeti i Pastër" që synon mbrojtjen e rrjeteve 5G nga furnizues dhe operatorë jo të besueshëm të telekomunikacionit.


ShBA-ja është duke komunikuar me shumë vende në botë për ta kundërshtuar bashkëpunimin e tyre me kompaninë kineze Huawei dhe rrjetin e saj 5G.

Uashingtoni e ka vendosur këtë kompani në "listën e zezë" pasi vlerëson se ajo paraqet rrezik për sigurinë kombëtare dhe e përdorë teknologjinë e saj për të spiunuar në emër të qeverisë

kineze. Në letrën e tij, presidenti Trump i ka bërë thirrje Shqipërisë ta zhvendosë ambasadën në Izrael, nga Tel Avivi në Jerusalem. "Ju inkurajoj që t'u bashkoheni Shteteve të Bashkuara dhe të tjera kombeve evropiane për zhvendosjen e ambasadës suaj në Jerusalem", thuhet në letrën të cilën presidenti Trump i ka dërguar kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama.

Kërkesa e presidentit amerikan ndaj Shqipërisë vjen disa javë pasi me marrëveshjen e nënshkruar në Uashington më 4 shtator, në praninë e presidentit Trump, Kosova është zotuar se do të vendosë marrëdhënie diplomatike me Izraelin dhe se do ta hapë misionin e saj diplomatik në Jerusalem, ndërsa Serbia është zotuar se do ta zhvendosë ambasadën e saj ekzistuese në Izrael nga Tel Avivi në Jerusalem. Presidenti amerikan e ka falënderuar Ramën për "mbështetjen në normalizimin ekonomik midis Serbisë dhe Kosovës dhe për mbështetjen e fuqishme të Marrëveshjeve të Abrahamit, si hapi më domethënës drejt paqes në Lindjen e Mesme për këtë gjeneratë".

Zvicra arreston tre shtetas të Kosovës, kishin "lidhje me IS-in dhe Al-Kaidën"



PRISHTINË, 2 TETOR - Autoritetet në Zvicër thonë se ata kanë arrestuar katër persona nën dyshimin se kanë lidhje me grupet militante ekstremiste Shteti Islamik (IS) dhe Al-Kaida. Prokuroria federale tha se policia kontrollon tri shtëpi në kantonin perëndimor të Friburgut të premten si pjesë e dy hetimeve penale në veprimtarinë e pretenduar ekstremiste. Të dyshuarit pretendohet të

kenë shkelur ligjin zviceran që ndalon përfshirjen me Al-Kaidën, IS-in dhe organizatat e lidhura me të, raporton agjencia Asosiated Press. Prokurorët thanë se katër personat e ndaluar dyshohen se kanë "mbështetur ose marrë pjesë në një organizatë kriminale". Ata identifikuan katër të dyshuarit vetëm si një grua 28-vjeçare nga Kosova, një burrë 26-vjeçar nga Kosova, një

34-vjeçar me dy shtetësi atë, zvicerane dhe të Kosovës dhe një 29-vjeçare maqedonase. "Ata kanë qenë në kontakt me njëri-tjetrin. Bastisjet dhe arrestimet në shtëpi u kryen të gjitha në të njëjtën kohë", thanë prokurorët.

Informacione të mëtejshme, përfshirë se cili prej të dyshuarve kishte lidhje me cilin grup, nuk janë bërë të ditura nga autoritetet.

Donald Trump dhe Melaina Trump rezultojnë pozitivë me Covid-19

UASHINGTON, 2 TETOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump dhe bashkëshortja e tij, Melaina Trump, kanë rezultuar pozitivë me Covid-19. Ishte këshilltarja e tij e afërt Hope Hick kishte rezultuar më herët pozitive me Covid-

19. Pas këtij rasti, çifti Trump bëri testin dhe tha se do të jenë në karantinë disa ditë. Në një postim të fundit në llogarinë e vet në "Twitter", Trump ka shkruar: "Dola pozitiv me Covid-19. Do të karantinohem menjëherë. Do ta kalojmë këtë së bashku".



Thaçi bisedon me Lajçakun: Kosova është e përkushtuar për dialog që çon në njohje reciproke

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka zhvilluar një bisedë virtuale me të dërguarin e posaçëm të Bashkimit Evropian (BE) për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. Presidenti Thaçi ka theksuar se Kosova është e përkushtuar për procesin e dialogut që çon në njohje reciproke, si mënyra e vetme për ta siguruar paqen afatgjatë në rajon dhe që do ta përshpejtonte procesin e integrimit në BE

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 TETOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka zhvilluar një bisedë virtuale me të dërguarin e posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. Thaçi ka thënë se në këtë bashkëbisedim është përsëritur që Kosova është e përkushtuar në procesin e dialogut, proces ky i cili duhet të çojë në njohje. "Diskutime të mira rreth dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe rrugën e Kosovës drejt Bashkimit Evropian me përfaqësuesin për dialog,

Miroslav Lajçak. Përsërita se Kosova është e përkushtuar për procesin e dialogut që çon në njohje reciproke, si mënyra e vetme për të siguruar paqen afatgjatë në rajon dhe që do ta përshpejtonte procesin e integrimit në BE", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Twitter".

Edhe Lajçak përmes një postimi në llogarinë e vet në "Twitter" ka shkruar për bisedën që ka pasur me presidentin Thaçi. Lajçaku ka thënë se Thaçi me përvojën e vet në këtë proces mund të ndihmojë shumë për ta siguruar përparimin e tij. "Kisha një video-konferencë shumë të frytshme me

presidentin Hashim Thaçi këtë mëngjes. E informova për arritjet e deritanishme në dialogun Prishtinë - Beograd të ndihmuar nga BE-ja. Përvoja e tij e gjerë në dialog mund të jetë e dobishme për progresin e mëtejshëm në procesin e ardhshëm", ka shkruar Lajçaku.

Një ditë më parë ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, ka vlerësuar se

qeveria amerikane dhe BE-ja janë vërtet të fokusuar në Ballkanin Perëndimor. Ai ka thënë se Kosova dhe Serbia, në procesin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve, duhet ta shfrytëzojnë këtë çast. Sipas tij, nëse Kosova dhe Serbia i marrin seriozisht zotimet e marrëveshjes së nënshkruar në Uashington, do të ketë përparime. "Ne jemi në një kohë kur qeveria

amerikane dhe miqtë tanë në BE janë vërtet të fokusuar në Ballkanin Perëndimor, që të bëhet përparim në këtë rajon. Mund t'ju them se ka mbështetje të të dy partive në ShBA për këtë gjë, por nuk mund t'ju premtoj se energjia aktuale dhe përkushtimi do të vazhdojnë përgjithmonë. Është e rëndësishme që të shfrytëzohet ky çast", është shprehur Kosnett.



Thaçi: Institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë traditë në mbrojtje të të drejtave të qytetarëve

PRISHTINË, 2 TETOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka takuar të premtën avokatin e popullit, Naim Qelaj, me të cilin ka diskutuar për punën e institucionit të avokatit të popullit në shërbim të qytetarëve të Kosovës. Duke e uruar avokatin për marrjen e detyrës së re, presidenti Thaçi ka theksuar rolin dhe rëndësinë e

veçantë të këtij institucioni për ta garantuar mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të Kosovës. "Në pritjen që i bëra Avokatit të Popullit të sapozgjedhur, Naim Qelaj, diskutuam për punën dhe përgjegjësinë e institucionit që ai do ta përfaqësojë dhe drejtojë brenda mandatit kushtetues. Tashmë institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë traditë në

mbrojtje të të drejtave të qytetarëve tanë pa dallim politik, etnik dhe religjioz. Z. Naim Qelaj, të cilit i urova punë të mbarë, u zotua se do të angazhohet me profesionalizëm, guxim dhe përgjegjësi që përmes besimit të dhënë ta forcojë institucionin e Avokatit të Popullit në shërbim të mbrojtjes së të drejtave të të gjithë qytetarëve", ka deklaruar presidenti Thaçi.

Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave dhe agjencia japoneze JICA arrijnë marrëveshje bashkëpunimi

PRISHTINË, 2 TETOR (ER) - Agjencia për Menaxhim të Emergjencave e Ministrisë së Punëve të Brendshme ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë Ndërkombëtare të Bashkëpunimit (JICA) të Japonisë. Me këtë marrëveshje do të bëhet implementimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm të Zjarreve Malore - (NFFIS) dhe Zvogëlimit të Rrezikut nga rrëshqitjet me

metoda ekologjike ECO-DRR. Ky projekt do të implementohet në periudhën pesëvjeçare, ku JICA do të financojë dhe ndihmojë me ekspertë për realizimin e kësaj marrëveshje. Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes morën pjesë Jiro Takeichi, përfaqësues kryesor i JICA Balkan Office, Mitsunori Ogasawara, ushtrues detyre i ambasadorit të Ambasadës Japoneze në Kosovë dhe drejtori i

përgjithshëm i AME-së, Fadil Kodra.

Drejtori i përgjithshëm i AME-së, Fadil Kodra, me këtë rast ka falënderuar shtetin japonez për vullnetin dhe besimin e shprehur në mbështetje të Kosovës për ngritjen e kapaciteteve në fushën e menaxhimit emergjent dhe shprehi gatishmërinë për bashkëpunim me qëllim të arritjes së rezultateve të përbashkëta.





Me moton “Bashkë pa kufi. Në një rajon pa kufij”, Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë kanë zhvilluar të premten në Tiranë mbledhjen e gjashtë të përbashkët

KOSOVA DHE SHQIPËRIA SYNOJNË HEQJEN E KUFIRIT MES DY SHTETEVE

Republika e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë kanë nënshkruar të premten katër marrëveshje, tri protokolle, pesë memorandume dhe kalendarin e përbashkët kulturor vjetor. Në mbledhjen e gjashtë të përbashkët të dy qeverive, kryeministrat e të dy vendeve kanë vlerësuar se me këto marrëveshje Kosova dhe Shqipëria po hyjnë në një fazë të re të bashkëpunimit tonë ndërshtetëror. Avdullah Hoti dhe Edi Rama kanë deklaruar se synim i përbashkët i Kosovës dhe Shqipërisë është heqja e kufirit në funksion të zbatimit të katër lirive të BE-së

zbatimit të marrëveshjes mes dy vendeve për hapjen e pikave të përbashkëta të pikëkalimit kufitar Morin - Vermicë. Kontrolli kufitar në pikën e përbashkët Morin - Vermicë funksionon sipas parimit një ndalesë, një kontroll”, ka deklaruar Rama. Por, sipas tij, kjo

nuk mjafton. “Ambicia jonë është heqja e kufirit në funksion të zbatimit të katër lirive të BE-së në rajonin tonë duke nisur nga më e thjeshta dhe më kuptimplota - heqja e kufirit mes Shqipërisë dhe Kosovës. Besoj se është e rëndësishme që Ministrinë e

Brendshme të të dyja shteteve ta shtojnë punën për ta mundur kontrollin në kohë reale të pikave kufitare, gjë që do të na mundësonte hapjen përfundimtare të kufirit pa humbur asnjë centimetër në frontin e betejës kundër

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 2 TETOR - Me moton “Bashkë pa kufi. Në një rajon pa kufij”, Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë kanë zhvilluar të premten në Tiranë mbledhjen e gjashtë të përbashkët, në të cilën janë nënshkruar marrëveshje, protokolle dhe memorandume të reja nga ministratë përkatëse, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit ndërshtetëror. Gjatë kësaj mbledhje kryeministri

i Kosovës, Avdullah Hoti dhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, kanë thënë se me këto marrëveshje po hyjnë në një fazë të re të bashkëpunimit ndërshtetëror. Ata kanë bërë me dije se të dy vendet synojnë heqjen e kufirit mes dy shteteve. Në hapje të mbledhjes së përbashkët, kryeministri Edi Rama ka thënë se dokumentet e nënshkuara janë në proces të zbatimit ose procesi i zbatimit të tyre ka përfunduar. “Dua ta nënvizoj ecurinë e mirë të



aktiviteteve të paligjshme dhe kundër çdo forme abuzimi me lirinë e lëvizjes”, është shprehur ai. Sipas Ramës, porti i Durrësit të kthehet në një port strategjik. “Ambicia jonë nuk duhet të ndalet vetëm në një stacion. Me këtë marrëveshje do të mundësojmë ligjërisht edhe kryerjen e kontrolleve të përbashkëta. Një port të përbashkët në Durrës të Shqipërisë dhe të Kosovës në funksion të gjithë rajonit. Së shpejti ne nisim pas një odiseje të gjatë ndërtimin e hekurudhës Tiranë - Durrës dhe ky hap tjetër besoj se shkon në drejtimin e duhur”, ka deklaruar Rama.

Kurse kryeministri Avdullah Hoti ka vlerësuar se me nënshkrimin e marrëveshjeve, të dyja vendet hyjnë në një fazë të re të një bashkëpunimi ndërshtetëror. Sipas tij, nënshkrimi i marrëveshjeve, memorandumëve dhe protokolleve tregon përkushtimin dhe vendosmërinë

për të ecur përpara në rrethana të reja. “Jemi mbledhur më parë në mbledhje të tilla dhe besoj se sot me këto marrëveshje hyjmë në një fazë të re të bashkëpunimit tonë ndërshtetëror bashkëpunimi në të gjitha fushat, pa përjashtim. Këto marrëveshje, memorandumë, protokolle dhe kalendari i përbashkët, të gjitha këto të koncentruara për lehtësimin e jetës së qytetarëve, lehtësimin e funksionimit të bizneseve në të dy shtetet tona, tregon përkushtimin që kemi dhe vendosmërinë e dy qeverive tona për të ecur përpara në rrethanat e reja”, ka deklaruar ai. Kryeministri Hoti ka folur edhe për politikën e jashtme dhe diplomacinë, duke thënë se së bashku me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe të gjithë resorët pa përjashtim, ka punuar shumë për t’i rivendosur marrëdhëniet e Kosovës me partnerët e natyrshëm strategjikë, BE-në, vendet kyçe të BE-së dhe me ShBA-në. “Na është dashur të marrim vendime jopopuliste, por tepër të nevojshme për ta dhënë sinjalin e duhur si qeveri se duhet të shihemi si kontribuues të paqes dhe stabilitetit në rajon dhe më gjer dhe punojmë së bashku drejt arritjes së objektivave përfundimtare që është një region i qetë, stabil, me një marrëveshje përfundimtare me fqinjin tonë verior dhe ku i gjithë regjioni së bashku do të lëvizim drejt integriteteve euroatlantike”, është shprehur Hoti, duke shtuar se Kosova mbetet vendi i vetëm pa liberalizim të vizave.

Ai ka deklaruar se qeveria po punon që sa më shpejt të ndodhë liberalizimi i vizave.

13 marrëveshjet e reja Shqipëri - Kosovë

Pas përfundimit të mbledhjes së përbashkët të dy qeverive, në një ceremoni solemne, nga ministrat përkatës të dy qeverive janë nënshkruar katër marrëveshje, tri protokolle, pesë memorandumë dhe kalendari i përbashkët kulturor vjetor. Këto janë marrëveshjet e nënshkruara në mes të dy qeverive: Memorandum

Rama: Mosliberalizimi i vizave për Kosovën është turp i BE-së

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, sërish ka shprehur kritika ndaj BE-së për mosliberalizimin e vizave për Kosovën. Në mbledhjen e përbashkët në mes të dy qeverive, e cila është mbajtur në Tiranë, ai ka thënë se mosliberalizimi i vizave për Kosovën është turp i pashlyeshëm i BE-së. Sipas tij, për këtë çështje

Kosova është marrë peng i logjikës elektorale në vende të ndryshme të BE-së. “Nuk e di çfarë duhet të besoj lidhur me liberalizimin e vizave me Kosovën. Më mbetet të përsëris që mosliberalizimi i vizave për Kosovën është një turp i BE-së, turp i pashlyeshëm. Kosova është marrë peng i dinamikave të

brendshme në vende të caktuara të BE-së, Kosova është marrë peng i logjikës elektorale në vende të ndryshme të BE-së dhe Kosova duhet të presë si të mbarojnë një palë zgjedhje në një vend dhe kur ka zgjedhje në një vend tjetër”, ka thënë Rama, duke shtuar se ende nuk e ka të qartë se pse po ndodh kjo.



bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës së Republikës së Kosovës mbi bashkëpunimin në fushën e Transportit Hekurudhor; Marrëveshje ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të Republikës së Kosovës për vlerësimin e krijimit të Fondit të Përbashkët në Mbështetje të Luginës së Preshevës; Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Bashkëpunim dhe Ndihmë të Ndërsjellë në Raste Fatkeqësish Natyrore dhe Fatkeqësive të Tjera; Protokoll për Ndryshim dhe Shtesë në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës

për Bashkëpunim të Ndërsjellë në Fushën e Sigurisë; Protokoll Ndryshues i Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë Lidhur me Tatimet mbi të Ardhurat dhe mbi Kapitalin dhe për Parandalimin e Evazionit Fiskal; Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Republikës së Kosovës për Mobilitetin në Punë; Memorandum Bashkëpunimi për Krijimin e Korridorit Digjital 5G, dhe Lehtësimin e Lëvizjes në të Ardhmen ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit të Republikës së Kosovës; Memorandum

bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës për themelimin e Ligës së përbashkët të basketbollit, ndërmjet Federatës Shqiptare të Basketbollit dhe Federatës së Basketbollit të Kosovës; Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Kosovës për Platformën e Përbashkët Digjitale të Arsimit Para universitar; Kalendari i përbashkët kulturor vjetor mes Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të Republikës së Kosovës; Marrëveshje për bashkëprodhim të filmit ndërmjet Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës; Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës; Protokoll shtesë i Marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e shëndetësisë ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës në përballje me Covid-19.



Ministria e Kulturës jep çmimet për teatër

**EPOKA
ERE****Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 2 TETOR - Zëvendësministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Engelbert Zefaj dhe Halil Matoshi, në një ceremoni solemne në kabinetin e MKRS-së, kanë bërë ndarjen çmimeve për teatër për vitin 2019.

Çmimi Kombëtar për Vepër Jetësore, që u ndahet personaliteteve të shquara në fushën e teatrit, për suksesin, të arriturat gjatë karrierës, risitë dhe kontributin e veçantë në avancimin e teatrit, iu dha aktorit dhe regjisorit Luan Daka pa asnjë votë kundër. Ky çmim iu dha atij duke u bazuar në kreativitetin e thellë, inovacionin dhe origjinalitetin që ai përfaqëson në fushën e artit dramatik si në teatër, film, televizion dhe radio.

Daka në rrafshin artistik është autor i teksteve skenike, regjisor i shfaqjeve, regjisor i radiodramave, aktor i suksesshëm i teatrit dhe filmit, ekspert i fushës teatrore dhe filmike, anëtar i jurive profesionale dhe në rrafshin akademik nga viti 1988 me përkushtimin dhe profesionalizmin tij pedagogjik ka nxjerrë me dhjetëra gjenerata të suksesshme të aktorëve.

Çmimi vjetor për shfaqjen më të mirë, që ndahet për shfaqjen që ka treguar sukses të jashtëzakonshëm për nga vlerat, profesionalizmi, shikueshmëria dhe suksesi në

prezantimin kombëtar gjatë vitit paraparak, me tri vota për dhe dy kundër iu nda shfaqjes “Erveheja” të regjisores Drita Begolli, me arsyetimin se kjo shfaqje është një vepër e jashtëzakonshme që korrespondon me realitetin e të gjitha kohëve. Çmimi vjetor për regjinë më të mirë, që ndahet për regjinë kreative, inovative dhe origjinale, në mënyrë unanime iu dha regjisores Elmaze Nura për shfaqjen “Koprraci”. Këtë çmim juria e ka ndarë duke u bazuar në nivelin e lartë artistik, kreativitetin e thellë, inovacionin teatrore, përkushtimin profesional dhe mjeshtërinë e lartë regjisoriale. Suksesi i jashtëzakonshëm i kësaj shfaqjeje si në rrafshin ndërkombëtar dhe atë vendor është arritur kryekëput në sajë të regjisë së Nurës, e cila këtë art të sentencës e sjellë në mënyrë origjinale, të pëlqyeshme dhe me vlera të reja estetike.

Me shfaqjen “Koprraci” Kosova është përfaqësuar në festivale të rëndësishme ndërkombëtare dhe mbarëkombëtare, duke marrë edhe shpërblim për regjinë më të mirë. Çmimi vjetor për aktorin/aktoren më të mirë, që i ndahet aktorit/aktorese që ka pasur performancë të shkëlqyeshme në një rol ose disa role teatrore, me shumicë votash, iu dha aktorit Adrian Morina për rolin në shfaqjen “Unë jam vetë grua”.

Me shfaqjen “Unë jam vetë



grua” Adrian Morina ka sjellë në skenë rrëfimin e shkëlqyer të transgjinoritetit dhe përmes karakterit të tij ka sjellë një rol të kompletuar.

Çmimi vjetor për prezantim të suksesshëm ndërkombëtar, që u jepet produksioneve teatrore, regjisorit, aktorit, dramaturgut, scenografit apo krijuesit për performancën dhe suksesin në prezantimin ndërkombëtar, në mënyrë unanime iu dha organizatës kulturore “Qendra Multimedia”, e cila realizoi disa prezantime ndërkombëtare në festivale prestigjioze dhe në të

njëjtën kohë ka bërë edhe prezantimin e Kosovës në fushën e teatrit.

Gjatë kësaj ceremonie zëvendësministri Zefaj e vlerësoi lart ndarjen e këtyre çmimeve dhe tha se “kam kënaqësinë që jemi të gjithë bashkë në këtë ditë të rëndësishme për teatrin ku ashtu siç është edhe tradita, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpërblen laureatët”. Duke i uruar të gjithë për çmimet, zëvendësministri Zefaj tha se “ndarja e këtyre çmimeve është një lloj respekti

dhe mirënjohje nga ana e institucioneve për angazhimin dhe punën kreative të artistëve, andaj sot uroj që puna dhe sukseset të mos mungojnë as në vitet e ardhshme”. Ndërkaq, fituesit e këtyre çmimeve falënderuan ministren Dumoshi dhe zëvendësministri Zefaj e Matoshi për përkrahjen e vazhdueshme dhe marrjen e çmimeve dhe ata e vlerësuan si një mirënjohje institucionale dhe një inkurajim për të punuar edhe më shumë në krijimtarinë e tyre artistike.



Haradinaj i jep medaljen ‘Me besim në zot, atdhe e shtet’ Esat Likajt

PRISHTINË, 2 TETOR (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, të premten i ka dhënë medaljen “Me besim në zot, atdhe e shtet” Esat Likajt, me motivacionin “për

kontribut për çështjen kombëtare”, në shenjë falënderimi për familjen atdhetare Likaj. “Kontributi i tyre për zhvillimin e vendit tonë vazhdon edhe sot”, ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në “Facebook”.

Bernard Nikaj përfundon mandatin e ambasadorit në Bruksel

PRISHTINË, 2 TETOR (ER) - Ambasadori i Republikës së Kosovës në Bruksel, Bernard Nikaj, e ka përfunduar me suk-

ses mandatin. “Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Republikës së Kosovës dëshiron t’i shprehë

falënderimet më të sinqerta për përfaqësimin e jashtëzakonshëm të Kosovës në Mbretërinë e Belgjikës. Suksese

dhe mbarësi në angazhimet e radhës, ambasador Nikaj”, ka njoftuar Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës.



Raporti 24-orësh i IKShPK-së: 54 të shëruar dhe 42 raste të reja me Covid në Kosovë

Asnjë person i vdekur nga Covid në 24 orët e fundit



Gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë nuk ka vdekur asnjë person nga Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur 42 raste të reja me koronavirus dhe janë shëruar 54 persona. Sipas IKShPK-së, që nga rasti i parë me Covid në muajin mars në vendin tonë janë infektuar me virusin "Korona" 15 705 persona, ku prej tyre 627 kanë vdekur dhe 13 731 janë shëruar. Kujtojmë se në Kosovë janë edhe 1 347 raste aktive me Covid

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 TETOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit në vendin tonë janë paraqitur 42 raste të reja me koronavirus. Po ashtu, sipas këtij njoftimi, gjatë kësaj periudhe janë shëruar edhe 54 persona nga Covid-19. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 645 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë

42 raste pozitive. Brenda 24 orëve nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 15 705 raste nga 69 108 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 627 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 54 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 13 731 raste, kurse numri i rasteve aktive është 1 347", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar numrin e rasteve sipas komunave. "Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 13 raste, komuna Fushë-Kosovë 6 raste, komuna Gjilan 3 raste, komuna

Lipjan 3 raste, komuna Podujevë 3 raste, komuna Viti 3 raste, komuna Malishevë 2 raste, komuna Obiliq 2 raste dhe me nga një rast Drenas, Ferizaj, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Rahovec dhe Skenderaj. Mbuloni gojën dhe hundën me maskë! Mbani higjienën! Respektoni distancën!", ka njoftuar IKShPK-ja.

Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se ka shprehur gatishmëri për të raportuar në Komisionin për Shëndetësi në lidhje me menaxhimin e pandemisë Covid-19. "Me shkresë zyrtare e kam njoftuar Komisionin për

Hoti përgëzon Zemajn dhe stafin shëndetësor për menaxhimin e pandemisë

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka përgëzuar ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj dhe të gjithë ata që janë të përfshirë në menaxhimin e pandemisë Covid-19. Një gjë të tillë Hoti e ka bërë pas rënies së numrit të rasteve të reja me Covid-19. "Sot kemi: 645 testime për Covid-19, 42 raste pozitive, 0 vdekje, 54 të shëruar. Përgëzime gjithë stafit shëndetësor, ministrin Zemaj dhe të gjithë atyre të përfshirë në menaxhimin e situatës", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Shëndetësi për gatishmërinë time për të raportuar rreth menaxhimit të pandemisë dhe legjislacionin në procedurë lidhur me sektorin e shëndetësisë. Sot lakorja e

situatës së pandemisë për 24 orët e fundit është e kënaqshme. Nuk ka asnjë rast të vdekjes së pacientëve nga Covid 19, ndërsa 42 kanë rezultuar pozitivë", është shprehur Zemaj.

Ministri Quni vizitoi kompanitë lidere të industrisë së mbrojtjes së Turqisë

PRISHTINË, 2 TETOR (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, gjatë qëndrimit zyrtar në Republikën e Turqisë, ka vizituar edhe kompanitë turke të industrisë së mbrojtjes në Ankara dhe Stamboll. Ai me delegacioni e vet vizituan Industrinë e Hapësirës Ajrore Turke (TAI) dhe kompaninë "Baykar" e cila zhvillon teknologjitë më të përparuara transformuese për fushën e aviacionit. Ata u njoftuan nga afër edhe me avionët, pajisjet

dhe sistemet që dizajnon kompania "Baykar" në bashkëpunim me kompaninë "Roketsan" si kompania kryesore e industrisë turke në teknologjinë e raketave. Gjithashtu, ministri Quni me delegacion vizitoi edhe kompaninë "Nurol", ndër prodhueset kryesore të automjeteve motorike tokësore dhe kompaninë "Aselsan" si prodhuese kryesore e sistemeve të komunikimit, radarëve, luftës elektronike,

mbrojtjes ajrore dhe të shënjestrimit. Edhe në këto kompani u njoftuan me automjetet, pajisjet dhe sistemet funksionale dhe ato në dizajnim e sipër. Këto vizita shënuan edhe përfundimin e vizitës shumë të suksesshme zyrtare të ministrit Quni e cila u realizua me ftesë zyrtare të homologut të vet turk, ministrin Akar, në funksion të thellimit të mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes.



Qeveria duhet t'i trajtojë me kujdes humbjet e industrisë së rëndë nga pandemia

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 2 TETOR - Ndikimi i Covid-19 në ekonominë e vendit po vazhdon të krijojë sfida të paprecedenta, sidomos për industrinë që varen nga punët që nuk mund të bëhen nga distanca, siç është ajo e industrisë së rëndë, derisa ndërmarrjet që operojnë në këtë industri kanë nevojë të theksuar për përkrahje nga qeveria. Këto u thanë në një forum virtual të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë mbi ndikimin e pandemisë në industrinë e rëndë.

Genci Beribashi, koordinator i projektit në NewCo Ferronikeli, ka potencuar faktin se gjatë kohës së pandemisë mbijetesa e

kompanive të industrisë së rëndë, përkatësisht metalurgjisë dhe sektorit minerar, varen jo vetëm nga masat e ndërmarrja nga Qeveria e Kosovës, por edhe nga tregjet ndërkombëtare që kanë ndikim në përfitimet nga eksporti. Ai ka theksuar se veprimtaritë e Ferronikelit sjellin një vlerë të shtuar në ekonominë e Kosovës, marrë parasysh faktin se kjo kompani shënon 40 për qind të eksporteve të vendit. Sipas tij, nga mosvazhdimi i veprimtarisë së Ferronikelit ekonomia e Kosovës ka humbur 8 deri në 9 milionë euro në muaj, ndërsa masat konkrete që mund të ndërmerren nga Qeveria e Kosovës për t'i ndihmuar kompanitë e këtij sektori janë reduktimi i taksave lidhur me rentat minerare, reduktimi i

tarifave për energjinë elektrike, si dhe garantimi i kredive të buta.


Valbonë Dushi, udhëheqëse e Departamentit të Industrisë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë, duke iu referuar disa statistikave të nxjerra nga raportet e kësaj ministrie, theksoi se gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 është vërejtur një trend pozitiv i rritjes së pjesëmarrjes së industrisë prodhuese në Bruto Produktin Vendor. Gjithashtu, e cilësoi si aspekt pozitiv rënien e importeve në Kosovë. Sipas saj, disa prej problematikave me të cilat është përballur kjo industri kanë qenë ndalja e investimeve kapitale dhe atyre të huaja.

Dushi, gjithashtu, tha se gjatë krijimit të masave kundër

efekteve të pandemisë janë marrë parasysh rekomandimet nga aktorët si odat ekonomike dhe komuniteti i bizneseve. Ai shtoi se me miratimin e programit për rimëkëmbje ekonomike kjo ministri do të ofrojë më shumë përkrahje për industrinë përpunuese si dhe për sektorët e tjerë të dëmtuar nga pandemia.

Hysen Vrajolli, udhëheqës i detyrës së kryeshefit ekzekutiv në Trepça, përmendi faktin se ndërmarrja që ai përfaqëson është goditur mjaft rëndë, marrë parasysh faktin se është minierë nëntokësore, prandaj shumica e masave mbrojtëse kundër virusit, siç është mbajtja e distancës, nuk kanë qenë të aplikueshme për punëtorët e Trepçës.

Vrajolli, gjithashtu, ka potencuar se rënia drastike e çmimeve në bursa ndërkombëtare, çrregullimet në zinxhirët furnizues dhe bllokimi i mineraleve në platforma transportuese kanë shkaktuar vonesa për përmbushjen e detyrimeve të përfshira në kontratat që Trepça ka lidhur me palë, duke krijuar kështu sfida në vete për kompaninë. Më tutje, ai theksoi se Trepça është mbështetur nga Qeveria e Kosovës përmes subvencioneve në vlerë prej 3.5 milionë eurove gjatë muajve të parë të pandemisë, duke theksuar se subvencionimi i stoqeve do të ishte një nga masat më efikase për ta siguruar vijimësinë e veprimtarive të ndërmarrjeve që i përkasin industrisë së rëndë.



Reçica në Tiranë nënshkruan marrëveshjen për unifikimin e tregut të punës Kosovë - Shqipëri

PRISHTINË, 2 TETOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, të premten, në Tiranë, në mbledhjen e dy qeverive shqiptare, bashkë me ministren e Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë, Anila Denaj, kanë nënshkruar Marrëveshjen për Mobilitet për Punë, e cila ka për qëllim përmirësimin e fushës së punësimit dhe aftësimin profesional dhe integrimin e një tregu të

përbashkët të punës Kosovë - Shqipëri.

Gjatë fjalës së tij, në mbledhjen e dy qeverive ministri Reçica ka theksuar se kjo marrëveshje është edhe detyrim që na ka shtruar historia. "Ne, Kosova dhe Shqipëria, po përmbushim nevojën e qytetarëve për lëvizje të lirë të punëtorëve, po hapim horizontet e bashkëpunimit dhe integritimit andej dhe këndej kufirit. Nga sot një korçar dhe

shkodran mund të marrë shërbime në Prishtinë e Prizren, një gjilanas në Vlorë apo në Elbasan, sikurse edhe të punësohen pa barriera burokratike dhe pa pengesa ligjore", ka thënë Reçica.

Ministri i MPMS-së, Skender Reçica, në fund të fjalës së tij ka thënë se është krenar që po bashkojnë tregun e punës Kosovë - Shqipëri, para se e ardhmja e afërt të na bashkojë në Bashkimin Evropian.



Veseli thotë se papërgjegjësia e qeverisë po rrezikon falimentin e qindra bizneseve

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka qëndruar të premtën në qytetin e Prizrenit, ku ka folur me përfaqësuesit e bizneseve prizrenase për sfidat me të cilat ata po ballafaqohen dhe për situatën e rëndë ekonomike në vend. Veseli ka thënë se papërgjegjësia e qeverisë po rrezikon falimentin e qindra bizneseve në vendin tonë

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRIZREN, 2 TETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka vizituar të premtën në Prizren shoqatën "Esnafe", që përfaqëson bizneset e këtij qyteti. Veseli ka folur me përfaqësuesit e bizneseve prizrenase për sfidat me të cilat ata po ballafaqohen dhe situatën e rëndë ekonomike në vend. Ai ka thënë se Partia Demokratike e Kosovës është e vendosur që t'i ndihmojë bizneset dhe, për këtë arsye, ka përgatitur një sërë propozimesh konkrete për qeverinë.

Megjithatë, Veseli ka thënë se papërgjegjësia e qeverisë po rrezikon falimentin e qindra bizneseve në vendin tonë, edhe

mijëra vende të punës. "Sot jam në Prizren për t'u solidarizuar me ju. E di gjendjen e rëndë ekonomike e cila po mbretëron në vend. I di sfidat me të cilat po ballafaqoheni ju si ndërmarrës. Prandaj, unë ju siguroj se ky nuk është faji i opozitës. Qeveria është duke u treguar tërësisht indiferente dhe e papërgjegjshme dhe me këtë po rrezikon shuarjen e shumë bizneseve në vend", ka thënë Veseli.

Më tej, ai ka shtuar se është i gatshëm që përsëri të ulët së bashku me qeverinë dhe të gjejnë një zgjidhje sa më parë për të mirën e vendit dhe bizneseve. "Qeveria duhet të ulët me odat ekonomike dhe me ne. Duhet t'i marrë parasysh propozimet tona. Kjo situatë kërkon bashkim

të të gjithë aktorëve politikë. Unë ju premtoj se sapo të ulemi për të diskutuar pakon e rimëkëmbjes, të nesërmen do ta votojmë atë në Kuvend", ka thënë Veseli.

Mes të tjerash, Veseli ka folur edhe për Trustin Pensional dhe për mundësinë që qytetarët t'i tërheqin paratë e tyre nga ai fond. "Ne duhet t'i kategorizojmë

shtresat e qytetarëve dhe t'ua kompensojmë paratë atyre që do t'i tërheqin. Në veçanti shtresës së ulët", ka deklaruar Veseli.

Kryetari i Shoqatës "Esnafe", Varis Xhejllani, ka falënderuar kryetarin e PDK-së për mbështetjen e tij të madhe dhe për propozimet konkrete se si t'u dilet në ndihmë bizneseve në

këtë kohë të vështirë të pandemisë. Ai ka thënë se bizneset janë në një situatë të vështirë dhe ka kërkuar nga qeveria dhe institucionet që të jenë bashkëpunues me të gjithë aktorët politikë në mënyrë që ndihma për ndërmarrësit të jetë sa më e shpejtë dhe sa më e madhe.

Në pritje të krijimit të vendeve të reja të punës

PRISHTINË, 2 TETOR - "Kosova për pesë vjet do të kthehet në një zonë të gjallëruar me mijëra vende pune", kjo është një nga deklaratat e kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, kur flet për marrëveshjen për normalizim ekonomik të nënshkruar më 4 shtator në Uashington ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Vendet e reja të punës, siç thotë Hoti, do të krijohen si rezultat i projekteve të shumta që mbërthen kjo marrëveshje, e cila ka në theks ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, si dhe disa projekte në fusha të tjera. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, çdo vit në tregun e punës hyjnë deri në 25 mijë persona, të gjithë të gjeneratës 18 vjeç e më lart. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shkalla e papunësisë në vitin 2019 ishte 25.7 për qind.

Profesori i ekonomisë, Berim Ramosaj, dhe kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, thonë për "Radion Evropë e Lirë" se projektet, të cilat janë në marrëveshje, duhet të konkretizohen në investime për të hapur vende të reja pune.



"Kjo paketë e një marrëveshjeje apo zotimeve të natyrës ekonomike nuk e ka ndoshta krejtësisht objektivin në politikat sociale. Qëllimi i asaj marrëveshjeje është që t'i inkurajojë palët që të tërheqin investime dhe ato investime pastaj kanë konsekuenca sociale, siç është punësimi i njerëzve dhe përmirësimi i mirëqenies sociale", thotë Ramosaj. Ai shton

se nëse realizohen ato projekte siç janë prononcuar nga liderët politikë në Kosovë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kosova do të mund ta ulë nivelin e papunësisë.

Oda Ekonomike e Kosovës do ta ndihmojë Qeverinë e Kosovës për t'i zbatuar projektet e marrëveshjes si dhe do të ofrojë mbështetje për zbatimin e projekteve të infrastrukturës,

energjisë dhe krijimit të vendeve të punës.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, thotë për "Radion Evropë e Lirë" se vendet e punës nuk krijohen me marrëveshje, por me tërheqje të investitorëve. "Vendet e punës nuk krijohen as me një marrëveshje, as me një projekt, kjo varet edhe nga ne, aq sa ne do të kemi projekte të tërheqim investime dhe financime të qëndrueshme që pastaj të njëjtat të kthehen në vende pune", thotë Rukiqi.

Ai bëri me dije se sektorët dhe projektet me mundësi të përfitimit të financimit amerikan janë Brezovica, Rugova (Borea), Fabrika e Baterive, Industria e Përpunimit të Ushqimit dhe projekte të tjera. Papunësia vazhdon të mbetet një nga problemet më të mëdha që e ka përcjellë shoqërinë e Kosovës vitet e fundit.

Niveli i papunësisë është rritur gjatë këtij viti edhe nga masat që Qeveria e Kosovës ka marrë për parandalimin e përhapjes së koronavirusit në Kosovë.

Shumë të punësuar kanë humbur vendin e tyre të punës dhe bizneset po ballafaqohen me vështirësi të mëdha financiare.

Kosova nuk ka një numër të saktë të qytetarëve që kanë humbur vendin e punës gjatë kohës kur Kosova po përballë me pandeminë Covid-19 por, sipas Odës Ekonomike të Kosovës, nëse merren parasysh shifrat e turrjes së mundshme ekonomike, deri në 25 mijë vende pune mund të humbin si pasojë e pandemisë.

Mekanizmat financiarë ndërkombëtarë në raportet e tyre të publikuara për efektet e pandemisë në ekonominë e Kosovës kanë vlerësuar se janë shkaktuar dëme të mëdha. Banka Botërore në raportin e saj ka paraparë një rënie ekonomike prej 4.5 përqindësh në Kosovë në vitin 2020.

Ekonomia e Kosovës pritet të tkurret rreth 5 për qind këtë vit si pasojë e pandemisë me koronavirus, mirëpo vitin e ardhshëm mund të kthehet në binarë me një rritje prej 4-përqindësh, thuhet në një raport të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh). Sipas BERZh-it, arsye për këtë rënie është zvogëlimi i investimeve (9 për qind), sektori i ndërtimit (12 për qind), si dhe ndikimi i pandemisë pothuajse në çdo sektor.

Bedri Tahiri dhuron dhjetëra ekzemplarë librash për bibliotekën “Ymer Elshani” në Drenas

DRENAS, 2 TETOR (ER) - Autori dhe veprimtari Bedri Tahiri ka dhuruar sërish dhjetëra ekzemplarë të librit të tij të fundit “Kamer e Murat Loshi” për bibliotekën “Ymer Elshani” në Komunën e Drenasit.

Dorëzimi i ekzemplarëve është bërë në objektin e Komunës së Drenasit, ku autori Tahiri është pritur nga nënkryetari Nazmi Hasi dhe drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Shqipe Zogu, me ç’rast e falënderuan për donacionin me libra.

Kjo nuk është hera e parë që

autori Bedri Tahiri dhuron libra, pasi edhe më parë ai ka dhuruar libra të zhanreve të ndryshme për nevojat e bibliotekave të shkollave në Drenas. Vetëm gjatë këtij viti donatorët kanë dhuruar mbi 1 000 ekzemplarë të zhanreve dhe gjuhëve të ndryshme bibliotekave të Komunës së Drenasit.

Dhurimi i këtij donacioni është në vazhdim e përbushjes së premtimit të kryetari Ramiz Lladrovci për pasurimin e bibliotekave me libra për nxënësit e Drenasit.



Begaj premton përkrahje për Shoqatën e të Verbërve në Malishevë

MALISHEVË, 2 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, të premten ka pritur në takim drejtorin e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, Mexhid Foniqin, si dhe kryetarin e Shoqatës së të Verbërve - Dega në Malishevë, Isak Krasniqin.

Qëllimi i vizitës, sipas drejtorit të SHVK-së, Mexhid Foniqi, ishte që të bisedojë me kryetarin Begaj për disa kërkesa dhe nevoja të personave të verbër që jetojnë në Komunën e Malishevës, si dhe për mbështetjen e Degës së ShV-në Malishevë, për zhvillim të aktiviteteve dhe realizim të projekteve të tyre.

Kryetari Begaj përfaqësuesve të ShVK-së u ka thënë se “kjo



kategori e personave është pjesë e pandashme e shoqërisë dhe deri më tash nga institucionet dhe qeverisja komunale janë mbështetur për të gjitha

nevojat jetësore, për realizim të projekteve me të cilat kanë konkurruar si dhe do t'i mbështesim edhe në të ardhmen kërkesat”, ka deklaruar Begaj.

Zbulohet pllaka përkujtimore për dëshmorin Hamdi Sheremeti

Mitrovicë, 2 tetor (ER) - Në Mitrovicë të premten është bërë zbulimi i pllakës përkujtimore në nderim të dëshmorit të kombit Hamdi Sheremeti, i rënë heroikisht në betejën e lavdishme të Koshares gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Pllaka përkujtimore është zbuluar në shtëpinë e dëshmorit, aty ku ai lindi dhe u rritë në frymë e

heroizmit dhe atdhedashurisë. Në ceremoninë e zbulimit të kësaj pllake të pranishëm ishin kryetari i komunës, Agim Bahtiri, Rrustem Berisha, ish-ministër i Mbrojtjes dhe komandant i “Brigadës 138 - Agim Ramadani”, Hisen Berisha, ish-komandant i UÇK-së në Koshare, përfaqësues të OVLUÇK-së, bashkëlufëtarë, familjarë dhe qytetarë të tjerë.



Covid-19, Komuna e Gjakovës përfiton 1 500 maska mbrojtëse



GIKOVË, 2 TETOR (ER) - Komuna e Gjakovës ka përfituar një sasi prej 1 500 copë maskash mbrojtëse, një donacion ky i ardhur nga kompania “Kosova Med Healthcare”. Ky donacion është pranuar nga kryetari i komunës, Ardian Gjini, gjatë një takimi që e pati të premten me drejtorin e

kompanisë “Kosova Med Healthcare”, Kastriot Asllani. Kryetari Gjini me këtë rast ka thënë se ky donacion, por edhe secila ndihmë e kësaj natyre, është e mirëseardhur për Komunën e Gjakovës, për faktin se komuna jonë është e angazhuar dhe e përkushtuar

maksimalisht për luftimin e pandemisë Covid-19, duke e vënë këtë në prioritetet kryesore. Sipas kryetarit Gjini, kjo sasi e maskave do të shpërndahet kryesisht në institucionet e shëndetit primar, në disa prej shkollave të komunës dhe te punëtorët e administratës komunale.

Në Gjilan bie numri i të prekurve me Covid-19

GJILAN, 2 TETOR (ER) - Komiteti i Gjilanit për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19 ka mbajtur të premten mbledhjen e radhës, nën kryesimin e drejtorit të Shëndetësisë, Selami Xhemaili. Në këtë takim është vlerësuar si lajm i mirë trendi i rënies së numrit të infeksionit në Gjilan, kurse u është bërë thirrje qytetarëve që të

vazhdojnë t'u përmbahen rekomandimeve të institucioneve për bartjen e maskave, distancën sociale dhe higjienën personale. Gjendja e përgjithshme e Gjilanit është kjo: 1 023 të infektuar në total, 910 të shëruar plotësisht, 69 raste aktive, 19 të hospitalizuar, 44 të vdekur dhe 30 mostra në pritje.



Rrjedhja e dokumenteve nga Gjykata Speciale, një goditje ndaj drejtësisë

Nga Dean B. PINELES

Rrjedhja e dosjeve të rasteve të krimeve të luftës në Kosovë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë mund ta komprometojë sigurinë e dëshmitarëve dhe ta pengojë ndjekjen penale të disa krimeve të tmerrshme. Lajmi i habitshëm për rrjedhën e disa dosjeve konfidenciale nga Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës në Hagë do të ishte një fabul emocionuese për një roman policor të John le Carre. Por, ky nuk është një roman. Kjo është diçka e vërtetë. Është një skandal dhe është serioze.

Mandati i Zyrës së Prokurorit të Specializuar për të ndjekur penalisht veteranë të rangut të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për krime të rënda të dyshuara se janë kryer gjatë dhe menjëherë pas luftës me Serbinë, nga viti 1998 në vitin 2000, mund të jetë në rrezik. Dhe kredibiliteti i Zyrës së Prokurorit, tashmë tepër i ulët midis shqiptarëve të Kosovës, tani mund të jetë dëmtuar ndjeshëm.

Siç dihet deri më tani, ato që pretendohet të jenë tre grupe dosjesh konfidenciale të Prokurorisë, duke përfshirë emra dëshmitarësh të mbrojtur dhe informacione të tjera tepër të ndjeshme, u dërguan në mënyrë anonime gjatë shtatorit në Organizatën e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Prishtinë.

Kreu i Organizatës së Veteranëve të Luftës, Hysni Gucati, dhe zëvendësi i tij, Nasim Haradinaj, kanë mbajtur tre konferenca për shtyp në lidhje me dokumentet, dhe Gucati u ka kërkuar

gazetarëve të Kosovës që të publikojnë përmbajtjen e tyre. Ai ka qenë një kundërshtar i zëshëm i Zyrës së Prokurorit të Specializuar, duke pretenduar se ajo është e njëanshme kundër UÇK-së dhe ai shprehet se këto dokumente vërtetojnë fjalën e tij. Haradinaj, në fakt, përmendi emrat e disa dëshmitarëve të mundshëm dhe ofroi informacione në lidhje me vendin ku ata jetonin dhe detaje të tjera personale.

Dosjet - origjinaliteti i të cilave as nuk është verifikuar dhe as nuk është mohuar në mënyrë të pavarur – janë kthyer në Zyrën e Prokurorit dhe, deri më tani, gazetarët kanë refuzuar të publikojnë ndonjë prej tyre, me sa duket nga frika e përgjegjësisë ligjore.

Megjithatë, 260 faqe dokumentesh konfidenciale nga Zyra e Prokurorit të Specializuar kanë mbërritur në stacionin televiziv Top Channel në Tiranë, Shqipëri, thuhet se nga një burim në Hagë. Sigurisht që kjo është diçka shqetësuese.

Disa faqe u publikuan së fundmi në faqen e internetit të këtij stacioni dhe, ndër të tjera, ato përmbajnë emra të të pandehurve të mundshëm dhe teori për përgjegjësi penale, të tilla si sipërmarrje e përbashkët kriminale dhe përgjegjësi komanduese. Thuhet se ky stacion televiziv planifikon gjithashtu të publikojë më shumë dokumente.

Nga ana e tyre, Gucati dhe Haradinaj janë arrestuar dhe janë dërguar në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë nën pretendimin për kanosje dhe hakmarrje ndaj dëshmitarëve që po bashkëpunojnë me

prokurorinë, si edhe për shpërndarje të të informacioneve konfidenciale në lidhje me punën e Zyrës së Prokurorit. Selia e Organizatës së Veteranëve të Luftës në Prishtinë është bastisur dhe kontrolluar.

Një rastësi, veterani i parë i UÇK-së që u padit nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, Salih Mustafa, u arrestua gjithashtu javën e kaluar në Prishtinë dhe u dërgua në Hagë. Ai doli në gjykatë bashkë me avokatin që iu caktua dhe ushtroi të drejtën e tij për të pranuar ose jo fajësinë.

Ironia e kësaj situatë është tepër e habitshme. Në të njëjtën kohë që Mustafa doli para gjykatës, Gucati dhe Haradinaj ishin në paraburgim për zbulimin e informacioneve konfidenciale që mund të ndikojnë negativisht në ndjekjen penale të Mustafës dhe veteranëve të tjerë të UÇK-së që do të vijnë pas tij. Haradinaj pati daljen e tij të parë në gjykatë të martën dhe sfidoi legjitimitetin e gjykatës. Gucati është planifikuar të dalë në gjyq të enjten.

Dëshmitarët mund të kenë frikë të dëshmojnë

Duhet supozuar se Zyra e Prokurorit po përpiqet me vendosmëri të identifikojë se si dhe nga kush janë marrë dhe rrjedhur dokumentet, si dhe të minimizojë dëmin e mundshëm nga kjo gjë.

Por edhe nëse hetimi i brendshëm është i suksesshëm, tashmë është bërë shumë dëm. Kjo tashmë ka ndodhur dhe nuk mund të zhbëhet.

Pse është kështu?

Një nga arsyt kryesore pse komuniteti ndërkombëtar

këmbënguli që Kosova të braktiste sistemin e drejtësisë të EULEX-it dhe të krijonte një Gjykatë Speciale jashtë Kosovës, ishte mbrojtja e integritetit të hetimit për këto krime të rënda të UÇK-së dhe mbrojtja e dëshmitarëve që mund të jenë të gatshëm të dëshmojnë kundër luftëtarëve të shquar dhe heronjve të luftës të UÇK-së.

Tani, integriteti i hetimit është komprometuar. Nëse mund të ndodhin rrjedhje dokumentesh si kjo që sapo ka ndodhur, atëherë asgjë nuk mund të konsiderohet më sekret.

Më e rëndësishmja, është vënë në rrezik siguria e dëshmitarëve që janë të gatshëm të bashkëpunojnë. Çdo dëshmitar që mund të ketë qenë i gatshëm të dëshmojë kundër veteranëve të UÇK-së dhe anonimati i të cilit është mbrojtur deri më tani, do të duhej të shqetësohej seriozisht për dëmtimin e tij dhe të familjeve të tyre nga mundësia që emrat e tyre mund të jenë rrjedhur gjithashtu.

Këta dëshmitarë tani mund të refuzojnë të dëshmojnë edhe nën masa të veçanta për të mbrojtur identitetin e tyre, duke qenë se emrat e tyre tashmë mund të dihen. Kjo do të ishte një pengesë e madhe për Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe do të ndikonte negativisht në ndjekjen penale të krimeve të tmerrshme.

Është e rëndësishme të kuptojmë se BE-ja shpenzoi 156,000,000 euro deri në qershor 2020 për Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe Dhomat e Specializuara të Kosovës, me 45,000,000 euro të tjera të alokuara për këtë vit, shumë e cila arrin në një total prej më shumë se 200,000,000 eurosh. Një shumë shastisëse nga çdo

standard objektiv.

Të dyja këto, në vitin 2019 u zhvendosën në një ndërtesë moderne në Hagë, të financuar bujarisht nga Norvegjia, dhe në të janë të punësuar rreth 200 njerëz. Kështu që dikush do të priste që Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe Dhomat e Specializuara do të kishin aftësinë, përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të përmbushur një nga përgjegjësitë e tyre kryesore - mbrojtjen e dosjeve konfidenciale, sidomos të atyre që përmbajnë emrat e dëshmitarëve, nga vjedhja dhe shpërndarja. Megjithatë, ata kanë dështuar në këtë drejtim.

Nuk ka asnjë mënyrë për të ditur se sa gjerësisht po qarkullojnë këto dosje. Dikush mund të mendojë me të drejtë se këto dosje mund t'i ketë marrë edhe dikush tjetër përveç Organizatës së Veteranëve të Luftës dhe "Top Channel". Dhe nuk ka asnjë mënyrë për të ditur nëse dhe kur në të ardhme, në një moment të leverdisshëm, mund të dalë në dritë ndonjë dosje tjetër. Ky skenar fatkeq nuk është diçka pozitive për Zyrën e Prokurorit të Specializuar, e cila ka punuar fuqishëm për vite me radhë për t'i përgatitur ndjekjet penale. Dhe kjo nuk mund të kishte ndodhur në një periudhë më të keqe, pikërisht ku filluan më në fund procedurat gjyqësore.

(Gjyqtari Dean B. Pineles është diplomuar në Brown University, Boston University Law School dhe Kennedy School of Government në Universitetin e Harvardit. Ai ka shërbyer si gjyqtar ndërkombëtar me EULEX-in nga viti 2011 deri në vitin 2013. Përveç se në Kosovë, ai ka përvojë në sundimin e ligjit në Rusi, Kazakistan dhe Gjeorgji).



SERBIA NE KËNGET SHQIPTARE



Ismet SYLEJMANI

Kënga shqiptare që është kënduar kudo, pjesë të sajë të pandarë e ka pasur Serbinë pushtuese!

Nuk ka këngë me motive patriotike e atdhetare, e në të cilën nuk përmendet Serbia pushtuese!

Të gjithë këngëtarët dhe këngëtarët e të gjitha zhanreve të muzikës, ku i këndojnë popullit, Atdheut dhe Kombit, Heronjëve e Dëshmorëve, veprimtarisë atdhetare e

kombëtare, luftës titanike të popullit shqiptar me emblemen e UÇK-së, në përmbajtjen e këngëve të tyre vend të veçantë i kanë dhënë Serbisë pushtuese!

Të gjithë artistët, këngëtarët e këngëtarët shqiptar kudo që kanë jetuar ata e kudo ku jetojnë sot, Serbinë pushtuese, Serbinë okupatore, Serbinë gjakëpirëse, Serbinë gjenocidale, Serbinë asimiluese, Serbinë shfarosëse, Serbinë antishqiptare e kanë kënduar me përbuzje të madhe, me urrejtje të madhe, me mllef të madh!

Serbia në këngët shqiptare kurre nuk është lavdëruar ndonëse nuk ka pasur pse të bëhej lavderimi, sepse edhe si pushtues nuk ka bërë asnjë të mirë!

Serbia pushtuese në këngët

shqiptare kurrë nuk është falenderuar për asgjë, se asgjë të mirë nuk i ka sjellur as si pushtuese Kosovës për ta falenderuar!

Serbia pushtuese dhe dhunuese e popullit dhe Atdheut tonë në këngët shqiptare është shfaqur ashtu siç ka qenë nëpër histori dhe ashtu siç ishte, e keqe, e poshtër, shtrigë, vrasëse etj., etj..!

Kënga shqiptare kundër Serbisë, ishte kushtim për popullin e për Kombin tonë!

Të gjitha epitetet dhe të gjitha etiketat, të gjitha sharjet dhe të gjitha fyrrjet, të gjitha ofendimet dhe gjithë përbuzjen, kënga shqiptare e ka derdhur kundër dhe mbi Serbinë pushtuese!

Kënga shqiptare ka qenë njeri prej gjeneratorëve dhe

katalizatorëve më të mëdhenj, që krahas organizimeve politiko-patriotike dhe betejave të shumta në të gjitha rrafshet të luftës për liri, çlirim e pavarësi të Kosovës dhe viseve të saja, ka luajtur rol të madh dhe vendimtarë, për ta mbajtur të gjallë e të ndezur flakën e luftës për ndarje përgjithmonë nga Serbia pushtuese!

Serbia në këngët shqiptare ze vend të madh dhe historia nuk do ta largojë e as nuk do ta harrojë!

Lufta heroike dhe titanike e UÇK-së dhe bombardimet e NATO-s mbi Serbinë, kanë qenë vula përfundimtare dhe finale e tërë asaj urrejtje të madhe që është grumbulluar me dekada e për një shekull të tërë kundër Serbisë pushtuese! Atë që nuk e bënte politika sepse nuk kishim politikë

patriotike legale, ngase ishim të pushtuar, dhe atë që nuk arrinte për ta bërë levizja politike patriotike, sepse kishte njëmijë e një pengesa, e ka bërë në masë të madhe kënga patriotike atdhetare çlirimtare shqiptare!

Kënga shqiptare është monument i madh në vete, por edhe meriton ti ngritet një monument, sepse e ka mbajtur të gjallë dhe të pashuar flakën e luftës për liri!

Lavdi e përjetshme këngës antiserbe patriotike atdhetare shqiptare!

Lavdi Heronjëve e Dëshmorëve të Kombit që kanë rënë në luftë për liri me këngë në gojë duke kënduar kundër Serbisë pushtuese e për lirinë dhe pavarësinë e Atdheut!

Prishtinë, 2 Tetor 2020!

Nënshkruhen katër memorandume bashkëpunimi në fushën e kulturës, mes Kosovës dhe Shqipërisë



Ministrja e Ministrisë së Kulturës Vlora Dumoshi ka njoftuar për memorandumet e nënshkruara mes Ministrisë së Kulturës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë. Në Mbledhjen e përbashkët të dy qeverive si Ministre e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Kosovës, nënshkrova sot katër memorandume të

bashkëpunimit. Memorandumi i bashkëpunimit për Veprimtarinë Botuese dhe Librin i cili ka për qëllim bashkëpunim të shumëfishtë me Shqipërinë për librin dhe botimin.

Memorandumi i bashkëpunimit për Kalendarin e përbashkët kulturor Kosovë – Shqipëri me

anë të së cilit do të bashkërendojmë aktivitete kulturore.

Memorandumi për Bashkëprodhim Filmik i cili do të ngrisë bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve filmike, Qendrës Kinematografike të Kosovës dhe Qendrës së Filmit të Shqipërisë në bashkëprodhim

filmik, dhe memorandum i cili parasheh ndarjen e çmimeve kombëtare të përbashkëta në kinematografi.

Memorandumi i bashkëpunimit për themelimin e Ligës së përbashkët të Basketbollit me anë të së cilit mbështetet themelimi i një lige unike të përbashkët të basketbollit ndërmjet Federatës

së Basketbollit të Kosovës dhe Federatës Shqiptare të Basketbollit.

Uroj dhe shpresoj që këto marrëveshje të forcojnë edhe më shumë marrëdhëniet tona vllazërore shtetërore dhe t'i ndihmojnë njëzëri kulturës e sportit andej e këndej kufirit shqiptar.

Eco: Interneti u ka dhënë hapësirë budallenjve

Lajmi për idiotët doli gjatë një konference shtypi, kur teksa i përgjigjesha një pyetjeje, bëra një vëzhgim krejt të arsyeshëm dhe logjik.

Nga shtatë miliardë banorët që ka planeti, ka një numër të pashmangshëm idiotësh, shumë prej të cilëve janë mësuar që ua komunikojnë përçartjen e tyre miqve apo të afërmeve në bar, kështu që opinionet e tyre janë të kufizuara në një rreth të caktuar. Një numër domethënës i këtyre njerëzve tashmë mund t'i shprehin mendimet e tyre në rrjetet sociale.

Prandaj opinione të tilla mbërrijnë në audienca të mëdha, dhe shkrihen bashkë



me shumë opinione të tjera, që shprehin njerëz të arsyeshëm. Ju lutem mbani parasysh që ideja ime për idiotët nuk kishte

konotacione negative. Askush, me pak përjashtime, nuk është idiot për nga profesioni, por dikush që është bakall i

shkëlqyer, mjek i shkëlqyer, apo një punonjës banke i shkëlqyer, mund të thotë disa broçkulla për gjëra që as nuk i njeh dhe as nuk i di, apo as nuk i ka menduar mjaftueshëm. Reagimet në Internet janë të menjëhershme, pa lënë kohë për reflektim. Është e drejtë që Interneti t'u lërë hapësirë atyre që nuk kanë asgjë të arsyeshme për të thënë, por tepria e budallallëkut është duke mbushur radhët.

Dhe disa reagime të pahijshme që kam parë në Internet, konfirmojnë pretendimin tim. Në të vërtetë, dikush raportoi se unë kam thënë që Interneti ofron të njëjtën famë, si për mendimet e një budallai, ashtu edhe ato të një fituesi të Çmimit

“Nobel”, dhe krejt papritur nisi një debat i kotë, që u bë edhe viral, mbi faktin nëse unë e kisha pranuar apo jo Çmimin Nobel – ndërkohë që askush nuk mori mundimin as të hapte Wikipedian. E gjithë kjo tregon se sa shumë të prirur janë njerëzit që të flasin, pa u ndalur për të menduar.

Në çdo rast, numri i idiotëve tani mund të kuantifikohet: 300 milionë. Raportohet se Wikipedia ka humbur 300 milion përdorues kohët e fundit. Këta janë të gjithë njerëz që lundrojnë, po nuk e përdorin më Internetin për të gjetur informacion, por preferojnë të rrijnë online duke biseduar me të singjashmit, dhe me gjasë pa u ndalur për të menduar.

Kerouac, Dylan, Marquez, apo guximi i shfrenimit


Ky tekst është fryt i bisedës mes shkrimtarëve amerikanë Jonathan Lethem dhe Dave Eggers, me rastin e botimit në Itali të librit të J. Lethemit: “Në perëndim të ferrit”. Shkrimi është botuar më 2003 në rubrikën “Oaza” të Javores Politike Shqiptare – “Zëri” (2003).

LETHEM B.: Ajo që më pëlqen nga diskutimi ynë mbi Bob Dylanin është se kemi dalluar një fenomen interesant: impulsi klasik, nga ana e fansave dhe kritikut, për të zgjedhur një periudhë të prodhimit të Dylanit si “e vetmja pjesë e vlefshme” për të bashkuar mandej tërë pjesën tjetër në një dënim të vetëm gjithpërfshirës: sikur Dylan u dashka të turpërohet për produktivitetin e vet të vazhdueshëm, sikur vëllimi madhështor i punës së tij qenka një lloj i krimi apo i sëmundjes që kërcënon dëgjuesin apo lidhjen e tij me albumet që i don. Sikur, kur një artist është tejet prodhimtar, tejet i gratshëm, të shkrepte një ndërprerës që e bën të shfaqet, befas, si një fyerje për publikun e vet.

Arrin një moment në të cilin shkrimtari, papritur, ndjehet i kërcënuar nga sasia e emrave të panjohur në raftet e librarive dhe vendos të shkruajë një artikull tipik ku deklaron se shkrimtarët e rinj që shfaqen në treg po bëjnë një lloj krimi, inflacioni, në dëm të letërsisë. Sikur librat e mirë mundkan të

zbërdhulen nga ekzistenca e librave më pak të mirë. Apo sikur dikush paska të drejtën të vendos cilët shkrimtarë meritojnë të vazhdojnë karrierën e tyre e cilët jo (nuk e di çfarë do të mbetej nga unë, po të më bëhej një gjykim kaq absolut, në botimin e romanit tim të parë!) apo sikur të botosh tregime i bëka keq dikujt.

EGGERS: Dylan është shembulli i përsosur, sepse përnjëmend është ai lloj i artistit, shumë i rrallë, që duke u mplakur ka vazhduar ta evoluojë stilin e tij, disa herë në mënyrë impresionuese, në të mirën e në të keqen. Prej kalimit në tingullin elektronik, në maskarë, në fazat mesianike, në videot pak të provuara në MTV, e kësajsoji me radhë. Mendoj se opinioni i përbashkët për Dylanin është se ka pasur shumë koncerte, për shumë kohë e se ka pasur shumë inkarnacione. Duket të ketë dhënë shumë, shumë mall edhe pse të mirë, shumë për një person të vetëm. Por Dylani është edhe viktimë, si shumica e muzikantëve dhe e artistëve posaçërisht pjellor, e paragjykit tonë për



përkorjen. Kur njëri nxjerr dy albume brenda vitit – Elvsi, të themi – apo një film në vit – Woody Allen – etj., menjëherë lind dyshimi: se mungojnë serioziteti, gravitasi, thellësia. Diçka e tillë. I injorojmë. Kemi arritur aty sa të presim një taksë të caktuar të prodhimit nga furnizuesit tonë kulturor: një fluks që jemi në gjendje ta elaborojmë, një frekuencë që mund të na bëjë të mendojmë se prodhimi kulturor përmban në vete një investim të caktuar kohe. Kerouac përçmohet për shpejtësinë me të cilën i shkruajti disa nga veprat e tij, si Nëntokësorët, ama me vonë e marrim vesh se Marquezi e ka shkruar Njëqind vjet vetmi shumë shpejt dhe mbesim konfuz, sepse është një libër i dendur dhe i përgatitur, pra është shkruar me një shpejtësi që nuk na duket e mundshme. E kjo na vë në hall, sepse nuk duam të mendojmë se për të shkruar vepra arti të cilësishë së

barabartë mund të nevojiten periudha kohe aq variable.


LETHEM: E saktë, bash kësajsoji: artistë si Kerouac apo Joyce Oates apo Picasso apo Prince priren të ngjallin përçmim sepse duket se shkarkojnë mbi publik përmbajtjen e trurit të tyre me një liri që nuk njeh detyrime apo përfundime. Kryeneçësia për të botuar bëhet objekt i admirimit dhe devotshmërisë: përkorja silitëse e artistit të bllokuar, të ngadalshëm dhe plot me vetvete. Ndërsa unë gjithmonë jam skeptik kur pandehet se mund të kuptohet diçka mbi “mjetet e prodhimit” të një artisti dhe shembulli yt për Marquezin tregon qartë absurditetin e kësaj pandehjeje.

EGGERS: Më duhet të pranoj se kam një preferencë për artistët prodhimi i të cilëve është i shpejtë dhe variues, sepse nëse e konsiderojmë prodhimin

artistik si një shprehje të dashurisë dhe shpresës – mendoj se për këtë bëhet fjalë, kur nuk lind nga zemërimi – atëherë do të thosha se preferoj ata që s'janë të zotët ta mbajnë në fre, që e bëjnë të çurgojë nga të gjitha poret. E Dylani është i tillë. Elvis Costello, po ashtu. Një tjetër shembull i mirë është Bowie.

LETHEM: Më pëlqejnë disqet e Bowies të një periudhe të caktuar, nga Hunky Dory te Lodger, ama kurrë s'kam arritur të ndihem i shqetësuar, konfuz apo i dëshpëruar sherri i ekzistencës së punëve të tij që nuk më interesonin, sepse admirimi im për Bowie gjithmonë ka qenë i modular dhe i mprehur nga ideja se ishte një krijues i hapur më tepër për bashkëpunime, i paanshëm dhe nganjëherë i pacipë. Është një teori e Freudit – e di që Freudi tashmë është jashtë mode, ama është e pabesueshme se sa është i zoti të zbulojë motivacionet e fshehta – e quajtur “narcizmi i diferencave të vogla”. Kam lexuar një libër të kritikës psikobiografike që guxonte të thoshte se narcizmi i diferencave të vogla shpjegon, për shembull, pse Nabokov tregonte haptaz se e urren Freudin. Sepse vizioni i tyre i sjelljes njerëzore ishte faktikisht i ngjashëm, në mënyrë shumë të rrezikshme. Po ajo energji mund të ushqejë inate sulmuese mes anëtarëve të grupeve të afërta: Fronti Popullor i Judesë kundër Frontit të Popullit Jadaik, të themi.

/Përktheu: Arben Idrizi/Telegrafi



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Lista e Challandesit, mungojnë Milot Rashica dhe Bernard Berisha

Zvicerani Bernard Challandes e ka zbardhur listën e “dardanëve” për ndeshjet e tetorit, kurse mungesa të mëdha janë Milot Rashica dhe Bernard Berisha. Për herë të parë në përfaqësuese është ftuar Florian Loshaj



PRISHTINË, 2 TETOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Bernard Challandes, e ka publikuar listën e futbollistëve për tri ndeshjet e këtij muaji. “Dardanët” fillimisht më 8 tetor do të luajnë kundër Maqedonisë së Veriut në gjysmëfinale të “play-off”-it për kualifikim në Kampionatin Evropian në Shkup, kurse më pas në kuadër të Ligës së Kombeve do të luajnë kundër Sllovenisë më 11 tetor në stadiumin “Fadil Vokrri” dhe kundër Greqisë, më 14 tetor në Athinë. Si zakonisht, “dardanët” do të akomodohen në hotel “Emerald”, kurse stërvitjen e parë do ta zhvillojnë të hënën në orën 19:00 në stadiumin “Fadil Vokrri”. Paraprakisht, të hënën në orën 11:00, në hotel “Emerald”,

përzgjedhësi Bernard Challandes do të mbajë konferencë për media. Për këtë ndeshje mungon Milot Rashica dhe Bernard Berisha, kurse kapiteni Samir Ujkani i bashkohet përfaqësueses më 9 tetor.

LISTA E FUTBOLLISTËVE

A. Muriq, V. Bekaj, M. Vojvoda, F. Hadergjonaj, B. Kololli, L. Paqarada, A. Rrahmani, F. Aliti, I. Dresheviq, H. Shala, A. Rashkaj, I. Voca, H. Kryeziu, B. Celina, F. Hasani, A. Zeneli, E. Rashani, F. Loshaj, F. Muslija, E. Zhegrova, V. Berisha, L. Kastrati, V. Muriqi, A. Nuhiu.

Prekazi publikon listën e lojtarëve për ndeshjen me Austrinë dhe Andorrën



PRISHTINË, 2 TETOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses U21, Rafet Prekazi, e ka publikuar listën e futbollistëve që do t'i ketë në dispozicion për dy ndeshjet kualifikuese të këtij muaji kundër Austrisë dhe Andorrës, të cilat zhvillohen më 9 e 13 tetor në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë. Në këtë listë spikasin emrat e Edi Sylisufajt, Alban Ajdinit, David Nreca-Besinger dhe Shaban Kuqut, që grumbullohen për herë të parë me dardanët e rinj, teksa rikthehet pas disa ndeshjeve mungesë edhe Arton Zekaj. “Dardanët” e rinj grumbullohen të hënën në hotel “International Prishtina”, derisa stërvitjen e parë e mbajnë po këtë ditë në

stadiumin “Rexhep Rexhepi” në Drenas në orën 15:00.

LISTA E FUTBOLLISTËVE

Florjan Smakiqi, David Ndreca, Fuad Rahimi, Leard Sadriu, Lirim Kastrati, Valon Hamdiu, Arbenit Xhemajli, Kreshnik Hajrizi, Leonat Vitija, Lumbardh Dellova, Gëzim Pepsi, Arton Zekaj, Edison Kqiku, Eris Abedini, Kreshnik Krasniqi, Qëndrim Zyba, Blend Baftiu, Muharrem Jashari, Altin Kryeziu, Alban Ajdini, Liridon Balaj, Valmir Veliu, Edi Sylisufaj, Mirlind Daku.

Sot fillon turneu ‘Lah Nimani’

PRISHTINË, 2 TETOR - Sot (e shtunë) Federata e Boksit e Kosovës organizon turneun ndërkombëtar “Lah Nimani” me boksierë të rinj (youth 17-18-vjeçar), i cili do të mbahet në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në

Prishtinë me fillim në orën 12:00. FboxK-ja do t'i respektojë këshillat nga IKShPK-ja, MKRS-ja, që në palestra të mbyllura mos të ketë më shumë se 50 persona (garues, trajnerë, delegatë dhe mjekë sportivë etj.) dhe turneu

do të zhvillohet pa publik. Federata e Boksit po vazhdon aktivitetet sipas kalendarit të garave dhe kalendarit nga Federata Evropiane EUBC dhe Federata Botërore AIBA. Gjyqtarë: Latif Demolli, Agim

Shala, Aliriza Rexhepi, Agim Tahiraj, Safet Sylja, Fadil Bekteshi, Visar Ibrahim, Granit Qorri, Marigona Beadini. Delegat do të jetë Sylejman Voca, kurse mjeku kujdestar Agron Kamberi.



Shaqiri do të largohet nga Liverpooli

LIVERPOOL, 2 TETOR - Xherdan Shaqiri nuk po gjënë hapësira në formacionin e Liverpoolit. Futbollisti nga Gjilani nuk është ftuar as në ndeshjen e fundit të Kupës

kundër Arsenalit. Në lidhje me këtë fakt foli edhe trajneri Jurgen Klopp, që la të kuptohet se Shaqiri nuk është më në plane dhe e ardhmja e futbollistit të për-

faqësueses zvicerane do të jetë diku tjetër. “Nuk mund dhe nuk dua të flas për këtë çështje. Mund të them vetëm që as nuk është i dëmtuar dhe nuk është

jashtë për çështje disiplinore, është periudhë merkatoje dhe trajneri vendos në bazë të informacioneve që i vijnë”, ka thënë Kloppi.



Batatina: Gaboni nëse mendoni se jemi dorëzuar

PODUJEVË, 2 TETOR (ER) - Pas tri humbjeve në tri ndeshjet e para në Superligë nga KF Llapi, Tahir Batatina ka reaguar nëpërmjet një postimi të gjatë në profilin e vet në “Facebook”. Trajneri që mori besimin e klubit një ditë më parë ka thënë se kushdo që mendon se Llapi është dorëzuar, gabon. Ai ka vlerësuar se kjo skuadër nga Podujeva është e pathyeshme dhe se do të rikthehet fuqishëm. “Nëse mendoni se jemi dorëzuar, jeni duke gabuar. Unë, skuadra dhe stafi së bashku me kryesinë jemi të pathyeshëm. Kemi humbur tri ndeshje, por nuk do të demoralizohemi. Futbolli është sfidë për ne. Unë jam mësuar me sfida nga mosha e re pasi gjithmonë i kam dashur sfidat dhe gjithmonë i kam kaluar me nder dhe krenari”, ka shkruar Batatina, i cili ka bërë me dije se projekti i vëllezërve Batatina në klubin e Llapit është 50-vjeçar. “Nuk ka rëndësi, humbje, barazim apo fitore, për mua ka rëndësi qyteti dhe qytetarët e Podujevës ku shumë shpejt do t’i bëjmë krenarë pasi nuk jam rastësisht në klubin e qytetit tim dhe projekti im dhe i vëllezërve Batatina është jo i shkurtër, por projekt 50-vjeçar për klubin dhe



qytetin ku çdo vit do ta ngrehim dhe avancojmë futbollin llapjan në nivele sa më të larta”, ka shtuar Batatina. Trajneri në fjalë ka parashikuar se Llapi do të jetë skuadra që buzëqesh në fund, pasi futbollistët aktualë e ndiejnë me zemër fanellën e klubit. “Djemtë e skuadrës do të mësohen me sfida dhe ato së bashku me njeriun e sfidave do t’i kalojmë bashkërisht, sepse ata e ndiejnë me zemër fanellën e klubit të cilën e mbajnë me nder dhe krenari. Shumë kanë filluar të qeshin herët,

por ai që buzëqesh në fund do të jetë K. F. Llapi. Së shpejti do ta shihni Llapin e vërtetë sepse djelmoshat duan dhe mund ta bëjnë atë kemi synim, pasi që jemi të bashkuar si asnjëherë më parë duke ditur se kemi një super president, një nënkryetar të shkolluar dhe një drejtor ekzekutiv të ngritur profesionalisht të cilët kanë kaluar sfida më të rënda”, ka deklaruar ai. Tahir Batatina beson se edhe në humbje edhe në fitore Llapi do të mbetemi skuadra që do ta thotë fjalën kryesore në kampionat.

Grupe të forta për Milanin dhe Napolin

NYON, 2 TETOR - Të premten është hedhur shorti i fazës së grupeve të Ligës së Evropës. Goglat nuk u treguan shumë bujare me Milanin, që e pret një grup shumë i vështirë. Kuqezinjtë do ta sfidojnë Celticun, Spartën e Pragës dhe Lille, teksa është e vështirë që të etiketosh një skuadër favorite për kalimin e grupit. Pa fat edhe Napoli, që nuk do ta ketë aspak të lehtë kualifikimin, pasi është shortuar me Real Sociedad, Alkmarin si dhe Rijekën në Grupin F. Tirana, po ta



GRUPET E LIGËS SË EVROPËS

Grupi A: Roma, Young Boys, Cluj, CSKA Sofia
Grupi B: Arsenal, Rapid W., Molde, Dundalk
Grupi C: Leverkusen, Slavia P., H. Beer-Sheva, Nice
Grupi D: Benfica, Standart L., Rangers, Lech
Grupi E: PSV, Paok, Granada, Omonoia
Grupi F: Napoli, Socidead, AZ Alkmaar, Rijeka
Grupi G: Braga, Leicester, AEK, Zorya L.
Grupi H: Celtic, Sparata P., Milan, LOSC
Grupi I: Villarreal, Qarabag, M.Tel-Aviv, Sivasspor
Grupi J: Tottenham, Ludogorets, LASK, Royal A.
Grupi K: CSKA M., Dinamo Z., Feyenoord, Wolfsburg
Grupi L: Gent, Crvena Zvezda, Hoffenheim, Liberec

kalonte Young Boysin mbrëmjen e së enjtes, do të ishte në një grup me Romën, Cluj dhe CSKA e Sofjes. Grup shumë interesant është padyshim ai G, ku Braga, Leicester dhe AEK do të sfidohen për të kaluar në turin tjetër. Me fat ndërkohë Tottenham që nuk pritet të ketë shumë probleme në Grupin J.

SHKURT

Caktohet orari i dy ndeshjeve të mbetura të Superligës

Komisioni i Garave ka caktuar orarin e ndeshjeve të mbetura të Superligës. Kësisoj, ndeshja e mbetur e javës së parë, Drita - Llapi, do të zhvillohet të shtunën (më 10 tetor), kurse ndeshja e javës së dytë Drita - Trepça '89 do të zhvillohet të mërkurën (më 14 tetor). Ndërkohë, për terminin e ndeshjes së mbetur të javës së 3-të, Prishtina - Drita, Komisioni i Garave do të vendosë më vonë.

Trajneri i Zvicrës: Zeqiri është në radarin tim

Trajneri i Zvicrës, Vladimir Petkoviç, nuk e ka përjashtuar mundësinë që ta ftojë Andi Zeqirin në të ardhmen në ekipin A të helvetikëve. Futbollisti i Kosovës u ftua sot nga Zvicra U-21 për ndeshjet kualifikuese të Evropianit 2021, por futbollistin kosovar po e ndjek me kujdes edhe Kombëtarja A. Derisa Kosova llogarit në të për të ardhmen, të njëjtën gjë po e bëjnë edhe zviceranët. “Ne jemi gjithmonë të singertë. Do ta marr atë në ekipin kombëtar kur të jem i sigurt se ai mund të na ndihmojë ne. Unë nuk do ta bllokoj kurrë atë. I kam folur qartë për këtë. Ai tashmë ishte në listën B. Ai është në radarin tim”, ka thënë Petkoviç. Zeqiri ka shkëlqyer në futbollin zviceran me ekipin Lausanne-Sport, ndërsa së fundmi u transferua në klubin nga Premierliga, Brighton. 21-vjeçari pritet ta ketë një karrierë mjaft të suksesshme.

Koeman: Kualifikohemi ne dhe Juventus

Barcelona dhe Juventus do të jenë në të njëjtin grup, ku do të kenë kundërshtarë edhe Dinamon e Kievit si dhe Ferencvarosin. Trajneri i Barçës, Ronald Koeman, ka deklaruar se ekipi i tij dhe “Zonja e Vjetër” duhen të kualifikohen më tutje. “Ne duhet të jemi të kënaqur me shortin. Barcelona dhe Juventus janë ekipet më të mira në grup. Ekipet e tjera duhen të jenë të lumtura që do të luajnë kundër nesh, por pa justifikime ne dhe bardhezinjtë duhet të kualifikohemi”, ka thënë Koeman.

Lukaku, lojtari i vitit në Ligën e Evropës

Sulmuesi i Interit, Romelu Lukaku, është zgjedhur lojtari më i mirë i sezonit të kaluar në Ligën e Evropës. Lukaku udhëhoqi Interin drejt suksesit në këtë garë, ku arriti deri në finale. Në finale është mposhtur nga spanjollët e Sevilas.

Liverpooli ende nuk ka bërë ofertë zyrtare për Mbappen

Ylli i Paris-Saint Germainit, Kylian Mbappe, pritet të largohet nga Franca sezonin tjetër, ku ky lajm ka alarmuar ekiye si Real Madrid, Liverpool e Manchester City. Sipas gazetarit Fabrizio Romano, krerët e Liverpoolit ende nuk kanë shprehur ndonjë interesim konkret për mundësinë e nënshkrimit me Mbappen. “Për momentin, nuk ka pasur kontakte mes Liverpoolit dhe PSG-së për ta siguruar blerjen e Mbappes verën tjetër. Duhet të presim disa javë që ta kuptojmë situatën. Liverpooli ende nuk ka bërë ndonjë ofertë zyrtare dhe, si duket, nuk janë duke punuar drejt pistës Mbappe”, ka thënë Romano për “Oddschecker”.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 271/1
Dt: 02.10.2020

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesës së shkollës, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPALLJE E KONKURSIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendra e Kompetencës në Skenderaj për vitin shkollor 2020/2021

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Një (1) instruktor/e në profilin ngjyrë punues, llak punues; normë e plotë	Vend i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor;

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t’i kryejë detyrat që mund t’ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 6 sipas KKK;
- Instruktor profesional me kualifikim: post sekondar, arsim të mesëm të lart;
- Të ketë më së paku 5 vjet përvojë punë në profesion në ndërmarrje biznese dhe institucione tjera;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatiqja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj. Aplikacionit duhet t’i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës. Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t’i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► “Zip Travel” shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr. 70563045.

► Bujar Malaj shpall të pavlefshme dokumentet e shkollës fillore “Lidhja e Prizrenit” Deçan.

► Arian Rexhë Malokaj shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Sami Frashëri” Irzniq Deçan.

► Shaqir Hodaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Emin Duraku " Prizren.

► Mahmut Memqaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Ibrahim Fehmiu " Arbane.

► Alban Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Shpend Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf " Dy Dëshmorët " Pirane.

► Imri Hoxhaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Dëshmorët e Zhurit " Zhur.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy bal-lkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobilu-ar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

